

**AKT- THEMELIMI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Megijon sh.p.k

Ne Durres, sot me date 08 Qershor 2023

Ortaku i vetem themelues:

**Z.Mario Hazisllari**, i datelindjes 26/04/1983, lindur ne Melove dhe banues ne Durres, shtetas Shqiptare, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me karte identiteti me numer I30426084L, me cilesine e "Ortakut themelues" kerkoj redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", ligjin nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ate Doganor,Fiskale Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, Megijon sh.p.k

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

Megijon sh.p.k


Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj Shoqeria Megijon sh.p.k, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasi shqipetar **Z.Mario Hazisllari**, i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

**Neni 3**



### Selia

Shoqëria e ka seline në Lagjen nr.8 autoveture tip Seat Leon me targat AB304IV Durrës. Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj , të hapë zyra përfaqësive, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

Bojaxhi dhe punime gipsi, punime të ndryshme të ndertimit, shtrim pllakash, vendosje mermeri.

### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

### KREU II

#### Kapitali

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mijë) leke, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njqind mijë) leke, i nënshkruar plotësisht nga ortakut vetëm themelues në masën 100%. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta). Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundëjt të treteve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### Neni 7



## Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise.Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve



- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

### Neni 9

#### Administrimi

Administrator i shoqerise Solargy, caktohet Z.Mario Hazisllari, i cila emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertritje.


Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem themelues te shoqerise.

### Neni 10

#### Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;



- d) Pergatimi dhe nënshkrimi i bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve të paraqesin këto dokumenta përpara asamblese së përgjithshme për miratim
- e) Krijohet një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tërëqeveritare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecanta për veprimtarinë e shoqërisë tërëqeveritare.

Administratori është i detyruar të theksojë në mbledhjen e asamblese në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratorët, së bashku edhe veças njëri tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorët e përfaqësojnë Shqipërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.


Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i administratorit kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### **Neni 11**

#### **Viti Financiar**

Viti Financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i përfundimtar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet më 31 dhjetor.

#### **Neni 12**



Shperndarja ose prishja e shoqeris mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqeris, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper".

### **Neni 13**

#### **Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis

### **Neni 14**

#### **Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlere te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**SHTETASI SHQIPTARE**

**Mario Hazisllari**

